



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. 2218 / Prot

Tiranë, më 16/10 /2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Neni 19 të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.189 prot, datë 08.09.2020 “Njoftim për vend të lirë pune në pozicionin nëndrejtor që mbulon kulturën e përgjithshme në shkollën Hoteleri-Turizëm” Tiranë, të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2218 prot, datë 10.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 18.09.2020, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Nëndrejtor që mbulon kulturën e përgjithshme

Kandidati aplikues për pozicionin e punës Nëndrejtor që mbulon kulturën e përgjithshme, në Shkollën e Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;

g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për nëndrejtorin, që mbulon kulturën e përgjithshme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master i shkencave” (ose të barasvlershme) në fushën e edukimit;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në arsim;
- d) të jetë vlerësuar të paktën “Mirë” në provimin e kualifikimit;
- e) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) CV (jetëshkrimi), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”;
- c) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në zyrën e protokollit të Shkollës së Mesme “Hoteleri-Turizëm” Tiranë brenda datës 29.09.2020.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

